

DEKLARATË PËR SHTYP

Maskilizmi toksik dhe stereotipet gjinore rrisin rrezikun e dhunës ndaj grave – sipas studimit rajonal 'Zërat e të Rinjve' në Ballkanin Perëndimor

Tiranë, 21 shtator 2023 – Maskilizmi toksik, stereotipet gjinore, gjuha e urrejtjes dhe shfaqja mediatike e roleve tradicionale gjinore rrisin rrezikun e dhunës, veçanërisht dhunës ndaj grave, e cila konsiderohet të jetë forma më e përhapur e dhunës në të gjithë rajonin – sipas një hulumtimi të ri të mbështetur nga UN Women.

Studimi i parë plotësisht i projektuar nga të rinjtë dhe i udhëhequr nga të rinjtë në rajon u fokusua në analizimin e lidhjes ndërmjet barazisë gjinore dhe bashkëjetesës sociale në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Maqedoninë e Veriut, Serbi dhe Kosovë¹. Gjetjet dhe rekomandimet e studimit u ndanë gjatë një aktiviteti në Tiranë me studiues të rinj, rrjete rinore dhe institucione nga pesë vendet e Ballkanit Perëndimor.

Studimi "Zërat e të Rinjve: Barazia Gjinore dhe Bashkëjetesa Sociale në Ballkanin Perëndimor" tregon se 32 për qind e të anketuarve/ave kanë qenë dëshmitar/e apo kanë përjetuar dhunë me bazë gjinore gjatë jetës së tyre, por stigma dhe turpi që i bashkangjitet i pengon ata/ato të flasin për të.

Mbi gjysma e të anketuarve/ave besojnë se dhuna me bazë gjinore ndikon negativisht në mirëqenien e të rinjve, 59% në Serbi, 54% në Kosovë, 52% në Shqipëri, 37% në Maqedoninë e Veriut dhe 28% në Bosnje dhe Hercegovinë. Të rinjtë theksuan se trashëgimitë negative të së kaluarës janë një pengesë e rëndësishme për barazinë gjinore dhe unitetin social, duke u përkthyer në izolim, frikë dhe mosbesim midis brezave.

Të rinjtë pjesëmarrës në studim mendojnë se pabarazia ekstreme vihet re edhe në aksesin në arsim dhe mundësitë e punësimit për gratë dhe vajzat, si dhe grupet e tjera minoritare, si migrantët, personat me aftësi të kufizuara dhe minoriteti rom. Gjithashtu, ata/ato theksuan se mungesa e edukimit shkollor për tema si barazia gjinore dhe shëndeti mendor, përjetëson efektet negative të normave të ngurta patriarkale dhe normalizimin e sjelljeve të dëmshme.

1200 të rinj morën pjesë në studimin e realizuar në kuadër të nismës së Kombeve të Bashkuara 'Rinia për përfshirje, barazi dhe besim' në Ballkanin Perëndimor, të mbështetur nga Fondi për Ndërtimin e Paqes të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së.

Pjesëmarrësit/et kërkuan që institucionet dhe politikëbërësit/et të inkurajojnë leadershipin nga të rinjtë, të forcojnë edukimin dhe ndërgjegjësimin për diskriminimin, dhunën me bazë gjinore, shëndetin mendor dhe të promovojnë dialogun mbi trashëgimitë historike, duke përdorur influencues/e që promovojnë modele pozitive në mediat sociale dhe kultivojnë sjellje dhe të menduar që nxisin bashkëjetesën sociale.

¹ Referencat për Kosovën do të kuptohen në kontekst të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit (1999).

Nisma rajonale e Kombeve të Bashkuara 'Rinia për përfshirje, barazi dhe besim' fuqizon të rinjtë të përfshihen në narrativa konstruktive, të forcojnë dialogun ndërkulturor, përfshirjen aktive, barazinë gjinore dhe të krijojnë mirëkuptim dhe besim të ndërsjellë në Ballkanin Perëndimor. Nisma dyvjeçare do të fuqizojë të rinjtë në promovimin e të kuptuarit dhe respektit për diversitetin në rajonin e projektit. Së bashku UNDP, UNFPA, UNESCO, UN Women, ministritë përkatëse lokale, këshillat komunale dhe rinore, partitë politike rinore, mediat, institucionet akademike dhe kulturore dhe organizatat e shoqërisë civile po punojnë në përmbushjen e qëllimeve të lartpërmendura, të mbështetura financiarisht nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, fondi për ndërtimin e paqes.